



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR

RREGULLORE

Nr. 1, datë 01.02.2007

RREGULLORE E BRENDSHME

E FUNKSIONIMIT TE KËSHILLIT TE DREJTIMIT



Bazuar në dispozitat e Statutit të IKM, nën 18, hartohet Rregullorja e Brendshme si vijon:

Neni 1

KËSHILLI I DREJTIMIT DETYRAT DHE KOMPETENCAT

Objekti dhe detyrat

1. Këshilli i Drejtimit siguron drejtimin e punës të IKM në periudhën midis dy Mbledhjeve të Asamblesë, bazuar në këtë Statut, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, se cilës i raporton për veprimtarinë e tij.
2. Këshilli i Drejtimit ka për detyre:
 - 2.01. Te sigurojë mbrojtjen e profesionit;
 - 2.02. Te ndjejë respektimin e rregullave të etikës profesionale në përputhje me kërkesat e Kodit të Etikës të hartuar në koherencë të plote me kodin e Etikës të IFAC dhe të bëjë plotësimin e tyre në qoftë se është e nevojshme;
 - 2.03. Te marrë masa parandaluese të nevojshme, për të mënjанuar çdo akt të natyrës që zhvlerëson profesionin dhe në rast nevojë vendos masa ose sanksionet e duhura në përputhje me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës pavarësisht gjykitimit civil apo penal;
 - 2.04. Te vendosë për çdo çështje, e cila lidhet ose përbën interes për profesionin e Kontabilistit të Miratuar.
 - 2.05. Te hartojë Rregulloret e funksionimit të brendshëm që ka në kompetencë sipas këtij statuti, organigramen e IKM, organigramen e Strukturës Ekzekutive dhe të Strukturave Drejtuese në rrethe.



- 2.06. Te miratoje rregulloret e hartuara nga Komitetet e ngritura pranë tij ne zbatim te këtij statuti sipas detyrave qe mbulojnë, përveç rregullores se Kontrollit te Cilësisë e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme
- 2.07. Te siguroje administrimin e pasurisë se IKM
- 2.08. Te siguroje funksionimin e rregullt te IKM dhe te koordinoje veprimtarinë e organeve te saj.
- 2.09. Te për zgjedh Drejtorin Ekzekutiv
- 2.10. Te organizoje kurset përgatitore për kualifikimin profesional te kandidateve te cilët do t’i nënshtrohen procesit te testimit për t’u pajisur me dëshminë “Kontabilist i Miratuar” ose për dëshmi të ngjashme;
- 2.11. Te organizoje dhe te monitoroje Edukimin e Vijueshëm te anëtarëve KM;
- 2.12. Te lëshoje dëshmi ose te certifikojë kualifikimet e anëtarëve te tij, qe organizon vete ose nga te trete;
- 2.13. Të miratoje Komisionin e Regjistrimit si dhe te miratoje Rregulloren e regjistrimit të anëtarëve dhe kandidatëve për Kontabilist te Miratuar dhe Regjistrin e publikueshëm.
- 2.14. Te organizoje dhe ndjeke veprimtarinë e Degëve dhe Seksioneve ne rrethe nëpërmjet strukturës ekzekutive;
- 2.15. Këshilli i Drejtimit përfaqësohet nga një anëtar i tij ne mbledhjet e Degëve dhe Seksioneve për zgjedhjen e organit drejtues, ne analizat vjetore, si dhe kur kërkohet nga drejtimi i Degës ose nga shumica e anëtarëve.
- 2.16. Te përgatisë e zbatoje buxhetin e IKM dhe t’i raportoje Asamblesë se Përgjithshme për plotësimin e buxhetit dhe për llogarite vjetore;



- 2.17. Te përfaqësojë IKM-n pranë organeve shtetërore dhe palëve të treta.
 - 2.18. Te bashkëpunojë me Ministrinë e Financave, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Komisionin e Provimeve të Aftësive Profesionale, institucione dhe organizma të tjera në fushën e kontabilitetit, të legjislacionit, kualifikimit të vijueshëm profesional të anëtarëve të IKM-se, etj.,
 - 2.19. Te angazhohet në organizimin e zhvillimit të provimeve të aftësive profesionale të kandidatëve për Dëshminë “Kontabël i Miratuar”.
 - 2.20. Bazuar në Statutin e IKM, dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të hartojë Programet e punës, të organizojë dhe ndjekë zbatimin e detyrave të programuara;
 - 2.21. Te vendosë për krijimin e Komiteteve të punës pranë Këshillit Drejtues dhe të ndjekë zbatimin e detyrave përkatëse.
 - 2.22. Si rregull në krye të çdo Komiteti caktohet një anëtar i Këshillit Drejtues.
 - 2.23. Vendos për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të Këshillit bazuar në këtë rregullore, në Statutin e IKM në mbledhjen e parë të Këshillit Drejtues mbas zgjedhjes nga Asambleja e Përgjithshme.
 - 2.24. Gjate zhvillimit të veprimtarisë mund të vendosë për caktimin e detyrave të reja ose ndryshimeve të nevojshme në detyrat e caktuara.
 - 2.25. Vendos për pagat e shpërblimet sipas kompetencave të caktuara në Statutin e IKM.
3. Këshilli i Drejtimit mund të krijojë Komisione ose Grupe pune teknike, të cilat ai gjykon të dobishme për të përmbushur objektin e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar. Këshilli i Drejtimit mund të ftojë persona jo anëtarë për të marrë pjesë në



Komisione ose Grupe pune. Miraton programet e punës të hartuara prej tyre dhe ndjek zbatimin e tyre.

4. Funksionet e tjera të Këshillit të Drejtimit caktohen nga Presidenti i tij, në marrëveshje me anëtarët e Këshillit të Drejtimit.

Neni 2

Përbërja e Këshillit të Drejtimit

5. Këshilli i Drejtimit përbëhet nga 7 (shtete) anëtarë ku me shumë se gjysma janë Kontabilistë të Miratuar aktiv dhe strukturoret si më poshtë:
 - 5.01. Kryetar i Këshillit të Drejtimit, i cili është njëkohësisht dhe President i Shoqatës.
 - 5.02. Zëvendës Kryetar i Këshillit të Drejtimit që është njëkohësisht dhe Zëvendës President i Shoqatës.
 - 5.03. Anëtarë, 5 (pese) individë, përgjegjës për çështje të tjera, të ndara sipas fushës profesionale.
6. Anëtarët e Këshillit të Drejtimit, përveç një anëtari që vjen automatikisht nga dega e IKM e Tiranës, zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.
7. Presidenti dhe zëvendësit të tij, zgjidhen për një mandat 4 vjeçar me të drejte rizgjedhje vetëm një herë.
8. Anëtarët e tjerë të Këshillit të Drejtimit zgjidhen për një mandat 4 vjeçar, me të drejte rizgjedhje vetëm pas kalimit të një mandati nga përfundimi i mandatit si i zgjedhur.



Neni 3

Mbledhjet e Këshillit të Drejtimit

9. Këshilli i Drejtimit si rregull mbledhet një herë në dy muaj.
10. Këshilli i Drejtimit mbledhet mbi bazën e njoftimit me shkrim të Kryetarit sa herë që e kërkojnë interesat e IKM. Në njoftim përcaktohet rendi i ditës, vendi dhe ora e mbledhjes dhe njoftimi shoqërohet me dokumentet e nevojshme.
11. Kryetari e thërret Këshillin e Drejtimit në mbledhje kur ka një kërkesë me shkrim nga të paktën tre anëtarë të tij. Në kërkesë duhet të përcaktohen çështjet për t'u përfshirë në rendin e ditës.
12. Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga Kryetari ose në mungesë të tij, nga Zv. Kryetari. Në mungesë të të dyve mbledhja e Këshillit të Drejtimit mund të kryesohet nga anëtari më i vjetër i Këshillit i pranishëm.
13. Këshilli i Drejtimit mund të marrë vendime kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Mbledhja e Këshillit të Drejtimit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 5 anëtarë.
14. Vendimet merren me shumicë absolute votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vota e Kryetarit, ose në mungesë të tij, e zëvendës Kryetarit, është përcaktuese.
15. Vendimet e Këshillit të Drejtimit reflektohen në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit të Drejtimit dhe personi i ngarkuar për mbajtjen e procesverbalit.
16. Anëtarët e Këshillit të Drejtimit, pjesëmarrës në mbledhje, firmosin listë prezencën e cila i bashkëngjitet procesverbalit të mbledhjes.



Neni 4

Revokimi

17. Një anëtar i Këshillit të Drejtimit i revokohet mandati nëse nuk merr pjesë 3 here radhazi në mbledhjet e KD, kur ka vendim gjykatë që nuk lejohet të ushtrojë profesionin apo i hiqet liria. Po ashtu KD mund të propozojë Asamblesë heqjen e mandatit të një anëtari të KD nëse ka konstatuar shkelje të rënda e të përsëritura të kryera nga anëtar i në dem të interesave të IKM dhe në kundërshtim me interesat e IKM.
18. Në rast revokimi, vdekje, dorëheqje ose çdo rasti tjetër të pengimit të anëtarëve të Këshillit të Drejtimit, Asambleja e Përgjithshme mund të kooptojë, deri në kryerjen e zgjedhjeve të ardhshme, një anëtar tjetër nga kandidatet që në zgjedhjet e mëparshme ka fituar numrin më të madh të votave, por nuk ka qenë zgjedhur anëtar i Këshillit të Drejtimit.
19. Bazuar në sa më sipër Këshilli i Drejtimit, brenda një muaji nga data e largimit të një anëtari të Këshillit, vendos caktimin provizor të kandidatit deri në datën e mbledhjes së Asamblesë së përgjithshme.
20. Numri i anëtarëve të kooptuar nuk mund të jete më shumë se dy. Në qoftë se krijohen më shumë se dy vende vakant, atëherë Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet, për të zgjedhur aq anëtarë sa mungojnë, përfshirë edhe anëtarët e kooptuar. Anëtarët e rinj të zgjedhur përfundojnë mandatin e anëtarëve që kanë zëvendësuar.
21. Heqja e mandatit të një anëtari të KD bëhet me kërkesë të kryetarit, të 2 anëtarëve ose të një kryesie të degëve apo seksioni të rrethëve. Në rast heqje mandate, përveç vdekjes, vendimi duhet të miratohet nga asambleja e përgjithshme e radhës.

Neni 5



22. Presidenti përfaqëson Institutin në marrëdhëniet me të tretet. Te gjitha dokumentet që dalin nga IKM duhet të jenë të nënshkruara nga Presidenti, ose në mungesë të tij, nga Zv. Presidenti.
23. Presidenti dhe në mungesë të tij Zv. Presidenti, mund të autorizojnë anëtarë të IKM për lidhje kontratash me të trete ose për të përfaqësuar IKM në marrëdhënie në Institucione ose organizma të tjera.

Neni 6

PËRBËRJA E KËSHILLIT TË DREJTIMIT

Presidenti i IKM:

24. Drejton punën e Këshillit të Drejtimit dhe të Këshillit të zgjeruar të kryetareve të Degëve e Seksioneve e objektivave të IKM në mbrojtje të profesionit, kualifikimit profesional, zbatimin e Kodit të Etikës profesionale, të rregullave profesionale, mënjanimin të konkurrencës së pa ndershme përgatitjen dhe zbatimin e Buxhetit, bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe institucione e organizma profesionale Brenda dhe jashtë vendit etj.
25. Kryeson mbledhjet e Këshillit të Drejtimit, mbledhjen e KZKDS, dhe mbledhjen e asamblesë të anëtarëve të IKM. Thërret mbledhjet e KD, KZKDS si dhe asamblesë të anëtarëve sipas parashikimeve të bëra në statut.
26. Në marrëveshje me anëtarët e këshillit cakton detyrat për secilin anëtar të Këshillit të Drejtimit.
27. Përfaqëson IKM në marrëdhënie me të tretet, nënshkruan të gjitha dokumentet që dalin nga IKM; në mungesë të tij autorizon të nënshkruajë Zv. Presidentin.
28. Nëpërmjet Strukturës Ekzekutive ndjek zbatimin e Vendimeve të Asamblesës Përgjithshme, të Programeve të miratuara nga asambleja dhe KD,, të Statutit dhe të dispozitave ligjore në fuqi.



29. Shqyrton propozime e probleme profesionale ose për dispozita ligjore, që paraqiten nga degët e seksionet ose anëtarë të IKM. Sipas rastit, mund t'i diskutoje me anëtarë të këshillit ose i paraqit në Këshillin e drejtimit për t'i dhënë rrugë zgjidhje
30. Ndjek zbatimin e detyrave nga anëtarët e Këshillit të Drejtimit, Komisioneve pranë Këshillit të Drejtimit Kryetareve të Degëve, Komitetit të kontrollit të brendshëm, Komitetit të Kontrollit të Cilësisë, nga struktura ekzekutive.
31. Presidenti firmos të gjitha vendimet e mbledhjeve të KD si dhe të asamblesë të anëtarëve

Zëvendës Presidenti:

32. Bashkëpunon me Presidentin për zbatimin e objektivave të IKM dhe të detyrave të tjera.
33. Zëvendëson Presidentin në mungesë të tij, nënshkruan dokumente, përfaqëson IKM me autorizimin të Presidentit.
34. Së bashku me presidentin drejton punën për mbrojtjen e profesionit, hartimin dhe zbatimin e Kodit të Etikës profesionale të Standardeve profesionale, për studime në fushën e kontabilitetit, të dispozitave ligjore e tatimore, etj.
35. Shqyrton propozime e probleme profesionale ose për dispozita ligjore, që paraqiten nga degët e seksionet ose anëtarë të IKM. Sipas rastit, mund t'i diskutoje me anëtarë të këshillit ose i paraqit në Këshillin e drejtimit për t'i dhënë rrugë zgjidhje.

Anëtarët e Këshillit të Drejtimit:

36. Secili prej anëtarëve të këshillit është përgjegjës për të organizuar dhe kryer punën e ngarkuar nga KD, në përputhje me komisionin ku merr pjesë.
37. Organizon dhe drejton çdo veprimtari në përputhje me detyrat e lëna nga KD apo asambleja e anëtarësisë. Merr pjesë në mbledhjet e degëve dhe seksioneve të IKM



ne rastet e caktuara nga KD si dhe përfaqëson KD ne këto mbledhje. Raporton në lidhje me ecurinë e mbledhjeve tek KD.

38. Bashkëpunon me anëtarët e tjerë, me strukturën ekzekutive dhe me drejtuesit e Degëve e seksioneve për çështje të ndryshme të ngarkuara nga KD.
39. Bashkëpunon me Institucione e organizma të tjera kur është i ngarkuar për të përfaqësuar IKM ose në rolin e anëtarit të komisioneve të ngritura pranë IKM.
40. Merr pjesë në mbledhjet e KD të IKM të thërritura nga kryetari i KD dhe luan rol aktiv në trajtimin dhe mbarëvajtjen e këtyre mbledhjeve dhe të çështjeve të trajtuar në to.
41. Mbështetin KD dhe strukturat ekzekutive për një zhvillim të aktiviteteve të tyre në përputhje me kërkesat e statutit dhe kërkesat e etikes profesionale

Kjo rregullore hyn në fuqi duke filluar nga data 01 Shkurt 2007

Kryetari i Këshillit të Drejtimit
Prof. Dr. Sotiraq DHAMO